



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.108

14 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 309 datë 22.7.2010	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.3, datë 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” 5369
Vendim i KM nr.527, datë 17.6.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Kryeministrinë 5369
Vendim i KM nr.567, datë 14.7.2010	Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njërive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”..... 5370
Vendim i KM nr.585, datë 23.7.2010	Për një përjashtim nga vendimi nr.53, datë 21.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar 5384
Vendim i KM nr.586, datë 7.7.2010	Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit, për vitin akademik 2010-2011..... 5384

LIGJ
Nr.10 309, datë 22.7.2010

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.3, DATË 8.7.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9643, DATË
20.11.2006 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 8.7.2010, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.6661, datë 30.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.527, datë 17.6.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për realizimin, prodhimin, transmetimin e spotit, organizimin e veprimtarive kulturore e të tjera, në kuadër të 20-vjetorit të rënies së komunizmit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.567, datë 14.7.2010

**PËR TRANSFERIMIN E REZERVUARËVE DHE SKEMAVE UJITËSE PËRKATËSE
NGA MINISTERIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT,
NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.1157, DATË 25.11.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË BORDEVE TË KULLIMIT, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 2.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (bordet e kullimit), në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, pa ndryshuar destinacionin, sipas listës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, e përcaktuar me vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, ndryshohet dhe bëhet sipas listës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë përditësimin e skemave ujitëse për çdo rezervuar të pasqyruar në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi dhe t’i propozojë Ministrisë së Brendshme përfshirjen e tyre në listat përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore, që i transferohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjësit kryesorë për sigurinë e objektit dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë e digave.

5. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit t’ia kalojë njësive të qeverisjes vendore, për çdo digë, sipas listës nr.1, të gjithë dokumentacionin teknik përkatës.

6. Në rastet kur rezervuari dhe skema ujitëse përkatëse humbin destinacionin për ujitje, për shkaqe të pavarura nga pronari i saj (njësia e qeverisjes vendore), Këshilli i Ministrave bën ndryshimin përkatës të destinacionit të pronës, sipas procedurës së mëposhtme:

a) Njësia e qeverisjes vendore paraqet kërkesën pranë Ministrisë së Brendshme, shoqëruar me argumentimin përkatës;

b) Ministria e Brendshme propozon vendimin për Këshillin e Ministrave, pas marrjes së mendimit nga:

- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (bordet e

kullimit), Ministria e Brendshme, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lista nr. 1

LISTA E 315 REZERVUARËVE (PËRFSHI DHE SKEMAT UJITËSE PËRKATËSE), QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Nr.	Institucionet e MBUMK-së që kanë në inventar rezervuarët dhe skemat ujitëse përkatëse	Emri i rezervuarit (+ skema ujitëse përkatëse), që transferohen	Emri i njësisë së qeverisjes vendore që i transferohet në pronësi rezervuari dhe skema ujitëse përkatëse	
			Komuna	Bashkia
1	QARKU BERAT		Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit Berat	Bistovicë		Ura Vajgurore
2	Bordi i kullimit Berat	Uznovë		Berat
3	Bordi i kullimit Berat	Mbjeshovë	Sinje	
4	Bordi i kullimit Berat	Mbolan	Sinje	
5	Bordi i kullimit Berat	Paraspuar	Terpan	
6	Bordi i kullimit Berat	Terpan	Terpan	
7	Bordi i kullimit Berat	Vokopolë	Terpan	
8	Bordi i kullimit Berat	Sheqëz (Hauz)	Lumas	
9	Bordi i kullimit Berat	Starovë (Hauz)	Velabisht	
10	Bordi i kullimit Berat	Dorës	Qendër	
11	Bordi i kullimit Berat	Nishicë	Qendër	
12	Bordi i kullimit Berat	Mollas	Qendër	
13	Bordi i kullimit Berat	Polonicë	Qendër	
14	Bordi i kullimit Berat	Muzhenckë	Çepan	
15	Bordi i kullimit Berat	Sevran	Çepan	
16	Bordi i kullimit Berat	Qafa 1	Potom	
17	Bordi i kullimit Berat	Qafa e Shelgut	Çepan	
18	Bordi i kullimit Berat	Zhepë	Zhepë	
19	Bordi i kullimit Berat	Kuç	Gjërbes	
20	Bordi i kullimit Berat	Strenecë	Potom	
21	Bordi i kullimit Berat	Koprenckë 2	Potom	
22	Bordi i kullimit Berat	Potom	Potom	

23	Bordi i kullimit Berat	Therepel	Vendreshë	
24	Bordi i kullimit Berat	Qeshibesh	Çepan	
25	Bordi i kullimit Berat	Strencë	Çepan	
26	Bordi i kullimit Berat	Koprenckë 2	Potom	
2	QARKU DURRËS		Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit Durrës	Rada nr.1		B.Manzë
2	Bordi i kullimit Durrës	Rada nr 2		B.Manzë
3	Bordi i kullimit Durrës	Lagj.Popullore		Shijak
4	Bordi i kullimit Durrës	Spitallë nr.1		Durrës
5	Bordi i kullimit Durrës	Spitallë nr.2		Durrës
6	Bordi i kullimit Durrës	Kareç	Maminas	
7	Bordi i kullimit Durrës	Koxhas,Helmës	Xhafzotaj	
8	Bordi i kullimit Durrës	Pjeza	Xhafzotaj	
9	Bordi i kullimit Durrës	Romanat	Rrashbull	
10	Bordi i kullimit Durrës	Memaj	Rrashbull	
11	Bordi i kullimit Durrës	Arapaj 1	Rrashbull	
12	Bordi i kullimit Durrës	Arapaj 2	Rrashbull	
13	Bordi i kullimit Durrës	Gjepalaj	Gjepalaj	
14	Bordi i kullimit Durrës	Shtrazë	Gjepalaj	
15	Bordi i kullimit Durrës	Çizmeli	Gjepalaj	
16	Bordi i kullimit Durrës	Shetel	Gjepalaj	
17	Bordi i kullimit Durrës	Shënpjetër	Ishëm	
18	Bordi i kullimit Durrës	Buras	Nikel	
19	Bordi i kullimit Durrës	Miciane	Thumane	
3	QARKU ELBASAN		Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit Elbasan	Belsh		Belësh
2	Bordi i kullimit Elbasan	Gjoli i Gjatë		Belësh
3	Bordi i kullimit Elbasan	Itamthi		Belësh

4	Bordi i kullimit	Elbasan	Plevicë		Belësh
5	Bordi i kullimit	Elbasan	NB Cerrik		Cërrik
6	Bordi i kullimit	Elbasan	Funar aksi 1/1	Funar	
7	Bordi i kullimit	Elbasan	Kollogjesh	Funar	
8	Bordi i kullimit	Elbasan	Mollogjesh	Funar	
9	Bordi i kullimit	Elbasan	Plangaricë	Gracen	
10	Bordi i kullimit	Elbasan	Përroi i Buallit	Kajan	
11	Bordi i kullimit	Elbasan	Mlizë	Shushicë	
12	Bordi i kullimit	Elbasan	Metaj	Rrasë	
13	Bordi i kullimit	Elbasan	Qendër Dëshiraj	Grekan	
14	Bordi i kullimit	Elbasan	Rrasë (Hysgjokaj)	Hysgjokaj	
15	Bordi i kullimit	Elbasan	Shtërmën	Gostime	
16	Bordi i kullimit	Elbasan	Prrenjas	Tunjë	
17	Bordi i kullimit	Elbasan	Tunjë	Tunjë	
18	Bordi i kullimit	Elbasan	Floq	Orenjë	
19	Bordi i kullimit	Elbasan	Hotolisht	Hotolisht	
20	Bordi i kullimit	Elbasan	Vehçan	Hotolisht	
21	Bordi i kullimit	Elbasan	Librazhd Katund	Qendër	
22	Bordi i kullimit	Elbasan	Gjocaj	Gjocaj	
23	Bordi i kullimit	Elbasan	Shezë nr 2	Shezë	
24	Bordi i kullimit	Elbasan	Shezë nr 3	Shezë	
25	Bordi i kullimit	Elbasan	Prroi i Zi nr.2	Shezë	
26	Bordi i kullimit	Elbasan	Prroi i Zi nr.3	Shezë	
4	QARKU FIER			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Fier	Çorrush nr 2	Kutë	
2	Bordi i kullimit	Fier	Greshicë	Greshicë	
3	Bordi i kullimit	Fier	Lalar	Portëz	
4	Bordi i kullimit	Fier	Libofshë	Libofshë	
5	Bordi i kullimit	Fier	Frakull e vogël	Frakull	
6	Bordi i kullimit	Fier	Ngjeqar	Kurjan	

7	Bordi i kullimit	Fier	Levan	Levan	
8	Bordi i kullimit	Lushnjë	Xeng 1		Divjakë
9	Bordi i kullimit	Lushnjë	Xeng 2		Divjakë
10	Bordi i kullimit	Lushnjë	Mizë		Divjakë
11	Bordi i kullimit	Lushnjë	Biçukas		Divjakë
12	Bordi i kullimit	Lushnjë	Germej		Divjakë
13	Bordi i kullimit	Lushnjë	Dushk Can		Divjakë
14	Bordi i kullimit	Lushnjë	Grabian nr 1	Grabian	
15	Bordi i kullimit	Lushnjë	Golem i vogël	Golem	
16	Bordi i kullimit	Lushnjë	Gramsh	Dushk	
17	Bordi i kullimit	Lushnjë	Gjuzaj	Ballagat	
18	Bordi i kullimit	Lushnjë	Garunjas	Ballagat	
19	Bordi i kullimit	Lushnjë	Canakaj	Hysgjokaj	
20	Bordi i kullimit	Lushnjë	Kurtina 2	Hysgjokaj	
21	Bordi i kullimit	Lushnjë	Kurtina 1	Hysgjokaj	
22	Bordi i kullimit	Lushnjë	Lekaj	Hysgjokaj	
23	Bordi i kullimit	Lushnjë	Ardenicë	Kolonjë	
24	Bordi i kullimit	Lushnjë	Kolonjë	Kolonjë	
25	Bordi i kullimit	Lushnjë	Fierseman	Gradishtë	
26	Bordi i kullimit	Lushnjë	Spolat 1	Gradishtë	
5	QARKU Gjirokastr			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Kelcyrë		Këlcyrë
2	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Selo-Klisharit	Dropull i Sipërm	
3	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Llongo	Dropull i Sipërm	
4	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Llovinë 1	Dropull i Sipërm	
5	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Llovinë 2	Dropull i Sipërm	
6	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Kakavijë 1	Dropull i Sipërm	
7	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Kakavijë 2 (Dritë)	Dropull i Sipërm	
8	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Pepel 3	Dropull i Sipërm	
9	Bordi i kullimit	Gjirokastr	Bodrishtë	Dropull i Sipërm	

10	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Qestorat 1	Lunxhëri	
11	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Minguli 1	Lunxhëri	
12	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Minguli 2	Lunxhëri	
13	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Gjatit	Lunxhëri	
14	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Blanjë	Lunxhëri	
15	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Çatistë 1	Pogon	
16	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Çatiste 2	Pogon	
17	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Polican	Pogon	
18	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Andon Poçi	Odrie	
19	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Hundkuqi	Odrie	
20	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Picar	Picar	
21	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Peshkëpi	Dropull i Poshtëm	
22	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Labovë e Kryqit	Qender Libohovë	
23	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Asim Zeneli	Antigonë	
24	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Suka (Goricë)	Sukë	
25	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Topojan	Sukë	
26	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Shelqi	Sukë	
27	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Varibob	Deshnicë	
28	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Xhanaj	Deshnicë	
29	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Sanican	Deshnicë	
30	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Fratar	Deshnicë	
31	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Ribanit	Deshnicë	
32	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Vitan 2	Deshnicë	
33	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Pacomit	Piskovë	
34	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Tremisht	Petran	
35	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Qilarishtë	Petran	
36	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Iljar nr.1(Strëmbeç)	Çarshovë	
37	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Iliara 3	Çarshovë	
38	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Zhepe	Çarshovë	
39	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Kenaj	Ballaban	
40	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Gjonkuç	Ballaban	
41	Bordi i kullimit	Gjirokastër	Bubzi 1	Ballaban	

42	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Bubzi 2	Ballaban	
43	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Krashovë	Frashër	
44	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Vercisht	Frashër	
45	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Frashër	Frashër	
46	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Krahësi 2	Krahës	
47	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Kalivaç	Krahës	
48	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Turani	Qendër Tepelen	
49	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Mamaj	Qendër Tepelen	
50	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Vasiar	Memaliaj	
51	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Cerila	Memaliaj	
52	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Sinanaj	Lopsit	
53	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Dhëmbllan	Lopsit	
54	Bordi i kullimit	Gjirokastrë	Rexhin	Kurvelesh	
55	Bordi i Kullimit	Gjirokastrë	Gusmar	Kurvelesh	
56	Bordi i Kullimit	Gjirokastrë	Buzi 2	Buz	
57	Bordi i Kullimit	Gjirokastrë	Rozeç	Buz	
58	Bordi i Kullimit	Gjirokastrë	Shalësi	Buz	
6	QARKU Korçë			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Korçë	Beras	Libonik	
2	Bordi i kullimit	Korçë	Kloce	Libonik	
3	Bordi i kullimit	Korçë	Boboshticë	Drenovë	
4	Bordi i kullimit	Korçë	Drenovë	Drenovë	
5	Bordi i kullimit	Korçë	Zapet	Drenove	
6	Bordi i kullimit	Korçë	Floq	Mollaj	
7	Bordi i kullimit	Korçë	Kamenice 5	Mollaj	
8	Bordi i kullimit	Korçë	Hollm Vodice	Mollas	
9	Bordi i kullimit	Korçë	Pepellash	Mollas	
10	Bordi i kullimit	Korçë	Shtike	Mollas	
11	Bordi i kullimit	Korçë	Grabockë 1	Vithkuq	
12	Bordi i kullimit	Korçë	Lubonja 1	Vithkuq	

13	Bordi i kullimit	Korçë	Lubonja 2	Vithkuq	
14	Bordi i kullimit	Korçë	Panarit 1	Vithkuq	
15	Bordi i kullimit	Korçë	Panarit 2	Vithkuq	
16	Bordi i kullimit	Korçë	Vithkuq Kroi i Kuq	Vithkuq	
17	Bordi i kullimit	Korçë	Vithkuq Makerz	Vithkuq	
18	Bordi i kullimit	Korçë	Gopesh 1	Moglicë	
19	Bordi i kullimit	Korçë	Kucaka 1	Moglicë	
20	Bordi i kullimit	Korçë	Moglicë	Moglicë	
21	Bordi i kullimit	Korçë	Protopapë 1	Moglicë	
22	Bordi i kullimit	Korçë	Protopapë 2	Moglicë	
23	Bordi i kullimit	Korçë	Protopapë 3	Moglicë	
24	Bordi i kullimit	Korçë	Protopapë 4	Moglicë	
25	Bordi i kullimit	Korçë	Peshtan	Moglicë	
26	Bordi i kullimit	Korçë	Popçisht	Moglicë	
27	Bordi i kullimit	Korçë	Gopesh 3	Moglicë	
28	Bordi i kullimit	Korçë	Vrepeckë	Moglicë	
29	Bordi i kullimit	Korçë	Varvara 1	Moglicë	
30	Bordi i kullimit	Korçë	Varvara 2	Moglicë	
31	Bordi i kullimit	Korçë	Zerec	Moglicë	
32	Bordi i kullimit	Korçë	Varavra 3	Moglicë	
33	Bordi i kullimit	Korçë	Nikollarë	Moglicë	
34	Bordi i kullimit	Korçë	Gopesh 2	Moglicë	
35	Bordi i kullimit	Korçë	Gropa Desmir	Gorë	
36	Bordi i kullimit	Korçë	Lirishtë (Lozhan)	Gorë	
37	Bordi i kullimit	Korçë	Tresovë 1	Gorë	
38	Bordi i kullimit	Korçë	Gjonomadh	Voskopojë	
39	Bordi i kullimit	Korçë	Gjergjevicë	Voskopojë	
40	Bordi i kullimit	Korçë	Voskopojë Zhombër	Voskopojë	
41	Bordi i kullimit	Korçë	Voskopojë 2	Voskopojë	
42	Bordi i kullimit	Korçë	Voskopojë 3-Krushor	Voskopojë	
43	Bordi i kullimit	Korçë	Vlitrinë	Pirg	
44	Bordi i kullimit	Korçë	Kakac	Pirg	

45	Bordi i kullimit	Korçë	Liçenas 1	Liçenas	
46	Bordi i kullimit	Korçë	Liçenas 2	Liçenas	
47	Bordi i kullimit	Korçë	Liçenas 3	Liçenas	
48	Bordi i kullimit	Korçë	Koshnicë 2	Miras	
49	Bordi i kullimit	Korçë	Bradvicë	Hoçisht	
50	Bordi i kullimit	Korçë	Cipan	Hoçisht	
51	Bordi i kullimit	Korçë	Bitinckë	Bilisht Qendër	
52	Bordi i kullimit	Korçë	Gostivisht	Qendër Ersekë	
53	Bordi i kullimit	Korçë	Kabash	Qendër Ersekë	
54	Bordi i kullimit	Korçë	Starje	Qendër Ersekë	
55	Bordi i kullimit	Korçë	Kaltanj	Çlirim	
56	Bordi i kullimit	Korçë	Lenckë	Çlirim	
57	Bordi i kullimit	Korçë	Orgockë	Çlirim	
58	Bordi i kullimit	Korçë	Selenice e Pishës	Çlirim	
59	Bordi i kullimit	Korçë	Piskal	Novoselë	
60	Bordi i kullimit	Korçë	Zharkanj 1	Novoselë	
61	Bordi Kullimit	Korçë	Zharkanj 2	Novoselë	
62	Bordi Kullimit	Korçë	Radanj 1	Leskovik	
63	Bordi Kullimit	Korçë	Pusia Grabovicë	Çërravë	
64	Bordi Kullimit	Korçë	Pllaçë	Dardhas	
7	QARKU Kukës			Komuna	Bashkia
1	Bordi i Kullimit	Kukës	Shtanë	Malzi	
2	Bordi i Kullimit	Kukës	Bardhoc 1	Tërthorë	
3	Bordi i Kullimit	Kukës	Bardhoc 2	Tërthorë	
4	Bordi i Kullimit	Kukës	Pobreg	Tërthorë	
5	Bordi i Kullimit	Kukës	Golaj 1	Golaj	
6	Bordi i Kullimit	Kukës	Golaj 2	Golaj	
7	Bordi i Kullimit	Kukës	Helshan 1	Golaj	
8	Bordi i Kullimit	Kukës	Helshan 2	Golaj	
9	Bordi i Kullimit	Kukës	Helshan 3	Golaj	

10	Bordi i Kullimit	Kukës	Nikoliq 1	Golaj	
11	Bordi i Kullimit	Kukës	Nikoliq 2	Golaj	
12	Bordi i Kullimit	Kukës	Berr		Krumë
13	Bordi i Kullimit	Kukës	Vranisht 1	Fajza	
14	Bordi i Kullimit	Kukës	Tregtan 1	Fajza	
15	Bordi i Kullimit	Kukës	Tregtan 2	Fajza	
16	Bordi i Kullimit	Kukës	Zherka 1	Bytyç	
17	Bordi i Kullimit	Kukës	Berisha nr. 1	Bytyç	
8	QARKU Lezhë			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Lezhë	Fishtë	Blinisht	
2	Bordi i kullimit	Lezhë	Troshan	Blinisht	
3	Bordi i kullimit	Lezhë	Petalaj	Kolsh	
4	Bordi i kullimit	Lezhë	Kashnjet	Ungrej	
5	Bordi i kullimit	Lezhë	Tarazh		Rëshen
9	QARKU Dibër			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Dibër	Ballgjaj	Suc	
2	Bordi i kullimit	Dibër	Blati	Ulëz	
3	Bordi i kullimit	Dibër	Burrel nr 2	Komsi	
4	Bordi i kullimit	Dibër	Midhe nr 2	Komsi	
5	Bordi i kullimit	Dibër	M.bujqësore	Komsi	
6	Bordi i kullimit	Dibër	Derjan 1	Derjan	
7	Bordi i kullimit	Dibër	Derjan 2	Derjan	
8	Bordi i kullimit	Dibër	Derjan 3	Derjan	
9	Bordi i kullimit	Dibër	Fires	Lis	
10	Bordi i kullimit	Dibër	Mallunx	Lis	
11	Bordi i kullimit	Dibër	Shoshaj	Lis	
12	Bordi i kullimit	Dibër	Laçi nr. 2	Rukaj	
13	Bordi i kullimit	Dibër	Macukull	Macukull	

14	Bordi i kullimit	Dibër	Vashkuqe	Baz	
15	Bordi i kullimit	Dibër	Brezhdan	Tomin	
16	Bordi i kullimit	Dibër	Catush	Tomin	
17	Bordi i kullimit	Dibër	Staravec	Tomin	
18	Bordi i kullimit	Dibër	Shimljan	Tomin	
19	Bordi i kullimit	Dibër	Cernetë	Maqellare	
20	Bordi i kullimit	Dibër	Maqellarë	Maqellare	
21	Bordi i kullimit	Dibër	Kastriot	Kastriot	
22	Bordi i kullimit	Dibër	Kander	Kastriot	
23	Bordi i kullimit	Dibër	Limjan	Kastriot	
24	Bordi i kullimit	Dibër	Lukan	Selishte	
25	Bordi i kullimit	Dibër	Qafëmurrë	Selishte	
26	Bordi i kullimit	Dibër	Ndërshenë	Rec	
27	Bordi i kullimit	Dibër	Vakuf	Muhurr	
28	Bordi i kullimit	Dibër	Ballenjë	Krastë	
29	Bordi i kullimit	Dibër	Liqeni Sopevë	Krastë	
30	Bordi i kullimit	Dibër	Rez. i Valit	Krastë	
31	Bordi i kullimit	Dibër	Mazhicë	Shupenzë	
10	QARKU Shkoder			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Shkodër	Zagore	Shkrel	
2	Bordi i kullimit	Shkodër	Iballë	Iballë	
11	QARKU Tirane			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Tiranë	Pezë Gjyslikane	Pezë	
2	Bordi i kullimit	Tiranë	Prroi i arave	Pezë	
3	Bordi i kullimit	Tiranë	Shpat	Baldushk	
4	Bordi i kullimit	Tiranë	Zaranika nr.1***	Petrelë	
5	Bordi i kullimit	Tiranë	Zaranika 2	Petrelë	
6	Bordi i kullimit	Tiranë	Tufinë	Dajt	

7	Bordi i kullimit	Tiranë	Shkallë	Dajt	
8	Bordi i kullimit	Tiranë	Kokli 2	Dajt	
9	Bordi i kullimit	Tiranë	Priskë e Vogël	Dajt	
10	Bordi i kullimit	Tiranë	Qafëmollë	Dajt	
11	Bordi i kullimit	Tiranë	Zall Her nr 1	Zall Herr	
12	Bordi i kullimit	Tiranë	Zall Her nr 2	Zall Herr	
13	Bordi i kullimit	Tiranë	Paskuqan	Paskuqan	
14	Bordi i kullimit	Tiranë	Bizë	Shëngjergj	
15	Bordi i kullimit	Tiranë	Sauk	Farkë	
16	Bordi i kullimit	Tiranë	Farkë	Farkë	
17	Bordi i kullimit	Tiranë	Kashar	Kashar	
18	Bordi i kullimit	Tiranë	Çalaberzez 1	Kashar	
19	Bordi i kullimit	Tiranë	Çalaberzez 2	Kashar	
20	Bordi i kullimit	Tiranë	Fortuzaj	Vaqar	
21	Bordi i kullimit	Tiranë	Lepur	Shëngjergj	
22	Bordi i kullimit	Tiranë	Mihajas	Berzhitë	
23	Bordi i kullimit	Tiranë	Sarakozë	Vorë	
24	Bordi i kullimit	Tiranë	Vile	Gosë	
25	Bordi i kullimit	Tiranë	Beden	Luz i Vogël	
26	Bordi i kullimit	Tiranë	Gjinaj	Helmas	
27	Bordi i kullimit	Tiranë	Habilaj 1	Helmas	
28	Bordi i kullimit	Tiranë	Habilaj 2	Helmas	
29	Bordi i kullimit	Tiranë	Sinaballaj	Sinaballaj	
30	Bordi i kullimit	Tiranë	Xinkular	Helmas	
31	Bordi i kullimit	Tiranë	Xhabjan		
32	Bordi i kullimit	Tiranë	Zambisht	Lekaj	
33	Bordi i kullimit	Tiranë	Momel		
12	QARKU Vlorë			Komuna	Bashkia
1	Bordi i kullimit	Vlorë	Kanina 1	Qendër	
2	Bordi i kullimit	Vlorë	Kanina 2	Qendër	

3	Bordi i kullimit	Vlorë	Bestrova	Qendër	
4	Bordi i kullimit	Vlorë	Zvërnec	Qendër	
5	Bordi i kullimit	Vlorë	Karroq	Livadhja	
6	Bordi i kullimit	Vlorë	Grava nr 1	Livadhja	
7	Bordi i kullimit	Vlorë	Leshnicë	Dhivër	
8	Bordi i kullimit	Vlorë	Dhivër	Dhivër	
	Totali	315 rezervuarë			

VENDIM
Nr.585, datë 23.7.2010

**PËR NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI NR.53, DATË 21.1.2009 I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përfundimisht, për të gjithë vitin kalendarik 2010, procedurat e prokurimit për shërbimin e ruajtjes me roje private të kryhen nga vetë autoritetet kontraktore.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.586, datë 7.7.2010

**PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË,
CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE PËR TARIFAT E
SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, janë 23 534, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë | 23 034; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 100; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 300; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 100. |

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë përbëhet nga:

- a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit 21 725;
- b) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 1264;
- c) Kuota për të verbërit (të veçanta) 20;
- ç) Kuota për romët (ballkano-egjiptianë) 25.

3. Kuotat e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave për kandidatët nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës kryhet nga ministrinë e arsimit dhe autoritetet përgjegjëse respektive, të cilat sjellin, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ua përcjell listat institucioneve publike të arsimit të lartë.

Në bazë të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, kandidatët nga Republika e Kosovës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në programe të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë. Kriteret e vlerësimit dhe të pranimit të tyre në këto programe studimi përcaktohen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe bëhen të njohura në median e shkruar e elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kuotat e pranimit, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimit për të verbërit ndahen për kandidatët me statusin e të verbërit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.

6. Kuotat e pranimit për romët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të Romëve.

7. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në ministri nga persona të interesuar.

8. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në vitin akademik 2010-2011, pasqyrohen në tabelën nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Kandidatët, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin e ri akademik 2010-2011, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale si: të verbër/të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, e të ish-të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Nga kjo tarifë vjetore shkollimi përjashtohen edhe studentët e viteve më të larta, që vijnë nga këto shtresa sociale.

10. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti përsëritës i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet.

11. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2010-2011, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 9 (nëntë).

12. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, si edhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur dhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

